UDHËZIM
Nr.7, datë 9.6.2010

PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN E ARSIMIT

Mbështetur në shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private. Me përpunim të të dhënave do të kuptohet çdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike me të dhënat personale, si: grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, ndreqja, këshillimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çfarëdo veprim tjetër, si dhe transmetimi i të dhënave.

2. Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ka dhënë më shumë të drejta individuale dhe krahas tyre, përgjegjësi më të mëdha për kontrolluesin e të dhënave personale, në mënyrë manuale apo automatike (kompjuterike). Ky udhëzim ofron një pasqyrë të shkurtër të këtyre ndryshimeve, të cilat përfshijnë veprimet që kryejnë institucionet e arsimit të lartë (IAL) si kontrollues në përpunimin e të dhënave personale.

3. Përditësimi i rregullave "mbi mbrojtjen e individit" zbatohet për të gjitha të dhënat personale që janë në përpunim.

4. Të gjithë kontrolluesit publikë dhe privatë, përpara se të kryejnë përpunimin e të dhënave personale detyrohen të mbajnë parasysh disa parime të cilat duhet të respektohet, si dhe një numër kushtesh që duhet të zbatohen nga kontrolluesit (që në mënyrë të detajuar parashikohen në udhëzimin e komisonerit nr.1, datë 26.2.2010 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale"), por në mënyrë të përmbledhur janë:

a) Qëllimet për të cilat kontrolluesit përpunojnë të dhëna;

b) Procesi i marrjes së të dhënave duhet të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;

c) Të dhënat nuk duhet të mbahen më shumë se është e nevojshme;

ç) I gjithë procesi i përpunimit duhet të bëhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

d) Çdo përpunim duhet të jetë i sigurt.

5. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet, me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Shtetet me nivel të mjaftueshëm parashikohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.934, datë 2.9.2009 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale". Lejohet transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, në një shtet tjetër, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, vetëm në rastet e parashikuara nga udhëzimi nr.1, datë 26.2.2010 "Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale", i nxjerrë nga Zyra e Komisionerit.

6. Mbështetur në ligjin nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të dhënat të mbahen jo më shumë sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Kontrolluesit e të dhënave kanë përgjegjësi dhe duhet të jenë të qartë në lidhje me hapësirën kohore për të cilat të dhënat do të ruhen dhe arsyen përse

informacioni është duke u mbajtur.

7. Çdo IAL përcakton një person përgjegjës për të siguruar që dosjet ose bazat e të dhënave të monitorohen rregullisht, me qëllim që të dhënat personale të mos mbahen më gjatë se koha e nevojshme. Çdo IAL zbaton:

a) Një politikë të qartë për periudhën e mbajtjes së të gjitha të dhënave personale në zbatim të legjislacionit në fuqi;

b) Rregulla të përcaktuara për menaxhimin, procedurat zyrtare dhe kompjuterike që zbatohen për të implementuar një politikë të tillë.

KREU II
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË SI KONTROLLUES TË TË DHËNAVE PERSONALE

1. Në nenin 58 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, parashikohet se:

a) Një institucion i arsimit të lartë duhet të mbajë regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore;

b) Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme;

c) Çdo studenti, në regjistrimin fillestar në një institucion të arsimit të lartë, i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Ministri i Arsimit dhe Shkencës përcakton rregullat për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.

2. IAL-të janë "kontrollorë të të dhënave" dhe nën mbikëqyrjen e ligjit ato përpunojnë "të dhënat personale" me të cilat studentët mund të identifikohen. Duhet pasur në konsideratë që të dhënat personale të përpunohen vetëm për aq kohë sa realizohet qëllimi për të cilin ato janë mbledhur. Pas realizimit të qëllimit, të dhënat personale mund të fshihen, ruhen apo të mbahen anonim për të hequr çdo karakteristikë të identifikimit, në qoftë se është e nevojshme për t'u përdorur për një qëllim tjetër, si p.sh.: kërkimor, historik, arkivor etj.

3. IAL-të përpunojnë informacion mbi studentët dhe duke bërë këtë, duhet të zbatojnë kërkesat e ligjit nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Kjo do të thotë se të dhënat e mbajtura për studentin duhet:

a) Të përdoren vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi të bëhet në përputhje me këto qëllime;

b) Të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;

c) Të saktësohen nga ana faktike dhe kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi e kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;

ç) Të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej;

4. Përpunimi i të dhënave bëhet sipas vendimit nr.2, datë 10.3.2010 "Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre" të Komisionerit.

5. Çdo kontrollues duhet të njoftojë pranë Zyrës së Komisionerit, në Drejtorinë e Regjistrimit, për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Këshillohet që nga ana juaj të caktohet një person, i cili do të përfaqësojë institucionin për të zbatuar me korrektësi ligjin nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Rastet të cilat përjashtojnë detyrimin për njoftimin e të dhënave që përpunohen parashikohen në vendimin e Këshillit të

Ministrave nr.1232, datë 11.12.2009 “Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale , që përpunohen”.

6. Qëllimet e përpunimit të të dhënave në IAL janë:

a) Për të mundësuar dhe administruar të dhënat e studentëve lidhur me funksione të tyre nga aplikimi fillestar deri në diplomim dhe më gjerë, për të menaxhuar marrëdhëniet në vazhdim me të diplomuarit;

b) Për të planifikuar dhe llogaritur shërbimet e ofruara;

c) Për të prodhuar informacion për projektet e ndryshme që qeveria mund të ketë për arsimin, për përcaktimin e fondeve për IAL-të në bazë të numrit të studentëve;

ç) Për t’i mundësuar stafit të IAL-ve të identifikojnë dhe të komunikojnë me studentët, ndërsa studiojnë në universitet, por dhe pas largimit të tyre;

d) Për të monitoruar progresin akademik gjatë një periudhe kohore drejt kualifikimeve;

dh) Për monitorimin e ankesave, p.sh.: ankesa të diplomave;

e) Për të siguruar shërbime mbështetëse të studentëve, duke përfshirë edhe shërbime me mbështetje financiare të studentëve (bursa, kredi etj.).

7. Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen nga IAL listohen më poshtë:

a) Të dhëna të mbledhura në regjistrat e të dhënave të studentëve:

- emri, mbiemri dhe adresa;
- data e lindjes;
- gjinia;
- kombësia dhe vendbanimi;
- kontaktet (numrat e telefonit, adresa e e-mail);
- zona e banimit të përhershëm;
- referenca akademike;
- numër unik matrikullimi;
- profesioni prindëror;
- të dhënat sensitive;
- dëshmi penaliteti[1].

b) Të dhëna të përditësuara:

- adresa e shtëpisë dhe e të afërmit;
- adresa ku është duke ndjekur universitetin;
- hyrja dhe kualifikime të tjera;
- informacione demografike;
- financimi, bursat dhe tarifat e dhëna;
- detaje bankare (p.sh. mandat pagesat);
- pjesëmarrjet, përparimi dhe statusi aktual;
- rezultatet përfundimtare;
- fotografi e studentit.

c) Të dhënat e mbledhura për qëllime të pajisjes me viza nga studentët që studiojnë jashtë shtetit është vërtetimi i lëshuar nga IAL-të ku kryen studimet, ku citohen:

- emër, atësi, mbiemër;
- ditëlindja dhe vendlindja;
- fusha e studimit;
- kursi i studimit (p.sh. student i vitit II).

KREU III
PËRHAPJA OSE NXJERRJA E TË DHËNAVE PERSONALE NGA IAL

1. Studentët kanë të drejtën e privatësisë së të dhënave personale. Duhet të merren masat

[1] Fakultative. Është një e dhënë që kërkohet në disa IAL.

e duhura të sigurisë kundër aksesit të paautorizuar, ndaj zbulimit apo shkatërrimit të të dhënave, si dhe për humbjen aksidentale të tyre. Standardet e larta të sigurisë janë thelbësore për të gjitha të dhënat personale.

2. Përpunimi i të gjitha të dhënave të studentëve brenda IAL-së, duhet të jetë rreptësisht i kontrolluar. Të dhënat personale sensitive duhen trajtuar me kujdes të veçantë dhe përpunimi i tyre bëhet sipas kritereve të parashikuara në nenin 7 të ligjit nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

3. Mbështetur në nenin 6 të ligjit nr.9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" parashikohet se të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin ("Pëlqim" është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij.).

4. Rastet përjashtimore kur përpunimi i të dhënave mund të bëhet pa pëlqimin e studentit, janë:

a) Kur personeli universitar ka nevojë për informacion për mësimdhënie, veprime administrative, apo qëllime vlerësimi;

b) Kur bëhet sigurimi i adresave të nxënësve dhe kurseve për anëtarët dhe për ata studentë të rinj që priten të regjistrohen;

c) Kur një organizatë që bashkëpunon dhe ofron kurse mësimore, vlerësim apo mbështetje për një kurs të universitetit (vetëm për studentët e regjistruar në një kurs të ofruar në lidhje me atë organizatë që bashkëpunon);

ç) Kur gjykata, policia dhe prokuroria merren me parandalimin e krimit apo funksionimin dhe zbatimin e ligjit;

d) Për urgjencat spitalore.

5. Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj. 6. Në të gjitha rastet, kjo nënkupton që ata nuk duhet t'i bëjnë me dije ndonjë personi të paautorizuar të dhëna personale, të cilat ata i shohin apo që i mësojnë gjatë punës. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit zgjat pambarimisht. Detyrimi nuk mbaron kur personat nuk ushtrojnë më funksionet e tyre. Thyerja e detyrimit të konfidencialitetit përbën vepër penale të parashikuar nga Kodi Penal (neni 123).

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Flora Çabej (Pogaçe)